



*Komuna Dragash*

**RREGULLORE**  
**PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019**

**Dragash, 30.11.2018**



## **Neni 2**

### **Zonat dhe Nën zonat tatimore**

2.1. Në komunën e Dragashit janë identifikuar tre zona për objekte banimi, komerciale dhe industriale:

2.1.1. Zona e parë: Përfshin qendër më të gjerë në qytezen e Dragashit.

2.1.2. Zona e dytë përfshin fshatrat Bellobrad, Bresane, Blaq, Brezne, Brod, Brut, Buce, Buzez, Globocicë, Kapre, Kosave, Krushevë, Kuk, Kuklibeg, Kukajan, Lubovishtë, Radesha, Rapca, Restelice, Mlik, Pllave, Shajna, Vraniq, Zaplluxhe, Zgatar, Zym.

2.1.3. Zona e tretë përfshin fshatrat: Pllajnik, Baqke, Dikance, Orçuse, Krstec, Leshtane, Zlipotok, Rrence dhe Xerrxe.

Për pronat e tjera të zonës, përcakton MEF komisionin e vlerësimit.

## **Neni 3**

### **Normat Tatimore**

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Dragash, cakton normat tatimore për vitin 2019 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

<b>Kategoria e Pronës</b>	<b>Norma tatimore</b>
Për njësitë bujqësore të parcelave	0,15%
Për njësitë bujqësore të objekteve	0,15%
Për njësitë pyjore të parcelave	0,15%
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0,15%
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0,17%
Për njësitë komerciale të parcelave	0,20%
Për njësitë komerciale të objekteve	0,20%
Për njësitë industriale të parcelave	0,18%
Për njësitë industriale të objekteve	0,18%

## **Neni 4**

4.1 Ligji për Tatimin në pronën e paluajtshme, me Nr.06/L-005, i cili është nënshkruar me 26.01.2018 dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronën e paluajtshme, e të cilat nuk janë përfshi në këtë Rregullore Komunale.

**Neni 5**  
**Shfuqizimi**

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren 01.Nr. 060/01-10846/2 datë 27.06.2017.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal Dragash dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2019.

**01.Nr.060/01-29651/1**

**Dt.30.11.2018**

**D r a g a s h**



Presuesi i Kuvendit  
**TIM MERDIU**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal  
01 Nr.060-01-29651/1  
Dt.30.11.2018  
D r a g a s h

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neneve 9 dhe 12 të Ligjit për Tatim të Paluajtëshmerisë dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, në seancën e XII-të (dy mbdhjetë) të dt.22.11.2018 të Kuvendit Komunal të Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, miratohet ky:

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Rregullorja Rregullorja mbi Tatimnin në Pronën e Paluajtëshme, për vitin 2019
- II. Ky Vendim zbatohet nga 1 Janari 2019.
- III. Për implementimin e këtij vendimi përkujdeset Zyra e Tatimit në Pronë e Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës së Dragashit, në bashkëpunim me shërbimet kompetente të Komunës-Dragash.
- IV. Për veprimet e mëtejme të njoftohet Kuvendi Komunal i Dragashit.
- V. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolli e Zyrës së MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Shaban Shabani,
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës-Dragash,
- Zyrës së Tatimit në Pronë të DEFZhvillim-Dragash,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë, dhe
- Arkivit

